



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2019:192501

Datë: 23.03.2023

Numri i dokumentit: 04116620

C.nr.658/19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirjeta Shala, me praktikanten Elvira Hoti, në çështjen juridike të paditësit H. M. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson av. Faruk Binakaj nga Peja, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, për zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, me datë 22 mars 2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia me numër C.nr.658/19 e ushtruar me datën 02.09.2019 e paditësit H. M. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson av. Faruk Binakaj nga Peja, e ushtruar kundër të paditurit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, për zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi H. M. nga fshati Skivjan, Komuna e Gjakovës, me datë 02.09.2019, në këtë gjykatë, përmes të autorizuarit të tij av. Faruk Binakaj nga Peja, ka parashtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, për zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë.

Në këtë çështje kontestimore i autorizuari i paditësit H. M., av. Faruk Binakaj ka qenë i ftuar për seancën e datës (22.03.2023 në ora 13:30/h), i njëjti e ka pranuar ftesën me datën 27.02.2023, mirëpo mungesën nuk e ka arsyetuar, nuk ka prezantuar në seancë as e paditura, për të cilën gjykata ka prova se është thirrur në mënyrë të rregullt, por mungesën nuk e ka arsyetuar.

Sipas nenit 409 paragrafi 1 të LPK-së “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet*”, e që në rastin konkret i autorizuari i paditësit ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, por që në seancë nuk ka prezantuar siç edhe u theksua më lartë, nuk ka prezantuar në seancë as e paditura, andaj, gjykata erdhi në përfundim se duhet vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, e konform nenit 409 paragrafi 1 në lidhje me nenin 387 par.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata lidhur me shpenzimet vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË  
-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil-  
C.nr.658/19 e datës 22 mars 2023

G j y q t a r j a,  
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.